

REPUBLIKA E SHQËTERISË  
DHOMA E NOTEREVE TIRANË

Nr. 2650 Rëp.

Nr. 171 Kol.



**KONTRATE SHITJE**  
E pjeseve te kapitalit themeltar  
te shoqërisë "DELTA PUBLICITY" Sh.p.k.

Në Tiranë, sot me datë 2 te muajit Nëntor dhe vitit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjet e nëntë (1999), perpara meje Noteres J. Ulliqi, u paraqiten palët si me poshtë:  
SHITESI: Ardian Mullahi, lindur ne Tirane me 30.1.1966, me kombesi e shtetesi shqiptare, banuese ne Tirane, Rruga "R. STAFKA" , Pall. 34A, Ap. 48, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nëpërmjet Leter Njofimit të tij nr. 0924386 dhe  
BLERËSI: Melsi Toska, lindur ne Tirane me 7.11.1965, me kombesi e shtetesi shqiptare, banues ne Tirane, Rruga "ELBANSATI" , Pall. 2, Ap. 29 madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nepermjet Leter Njofimit të tij QN Nr. 294747

te cilet kerkuan redaktimin e kontrates si me poshte:

Z. Ardian Mullahi, i cili me poshte ne kete kontrate do te quhet per lehtesi "Shitesi", eshte Ortak ne shoqerine "Delta Publicity" Sh.p.k. dhe zoterues i 100% te pjeseve te kapitalit themeltar te saj, fakt te cilin e verteton me vendimin nr. 19131, date 27.3.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane me te cilin eshte bere regjistrimi perkates ne Regjistrin Tregtar prane kesaj gjykate.

Z. Melsi Toska, i cili me poshte ne kete kontrate do te quhet per lehtesi "Bleresi", kërkon të bleje të gjitha pjeset e kapitalit të shoqërisë "Delta Publicity" Sh.p.k.

Shitesi deklaron se deshiron te shese te gjitha pjeset e kapitalit te zoteruara ne shoqerine "Delta Publicity" Sh.p.k., te cilat perbejne 100% te kapitalit te shoqerise, pjese te cilat ja shet me çmimin prej 100 000 (Njëqindmijë) Leke bleresit Melsi Toska.

Bleresi deklaron se eshte plotesisht dakort me blerjen e pjeseve te kapitalit te shitura nga ortaku Ardian Mullahi. Gjithashtu ai pranon çmimin e propozuar nga shitesi dhe deklaron e verteton se pagesen prej 100 000 (Njëqindmijë) Leke e ka bere me Mandat Pagesen Nr. CASH, date 2.11.99 ne favor te shitesit perpara nenshkrimit te kesaj kontrate.

Shitesi deklaron se perpara nenshkrimit te kesaj kontrate ka marre vleften e shitjes se pjeseve te kapitalit themeltar permendur me siper, dhe se nuk ka e nuk do te kete asnje kerkese apo pretendim ndaj bleresit mbas nenshkrimit te kesaj kontrate.



Bleresi deklaron se pranon dhe merr persiper te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga blerja e pjeseve te kapitalit si me siper dhe shitesi nuk do te kete asnje detyrim ndaj Shoqërisë "Delta Publicity" Shpk, ortakut Melsi Toska apo te treteve per detyrimet qe mund te kete shoqeria "Delta Publicity" ndaj tyre.

Mbas kesaj shitje shoqeria "Delta Publicity" Sh.p.k. do te perbehet nga nje ortak i vetem Z.Melsi Toska, i cili zoteron 100% te pjeseve te kapitalit te saj.

Kjo kontrate shitje behet ne mbeshtetje te dispozitave te Kodit Civil, ligjit nr. 7638, dt.19.12.1992 "Per shoqerite Tregtare" dhe statutit të shoqërisë "Delta Publicity".

Kontrata hartohet ne kater kopje origjinale, nga te cilat njera depozitohet ne noteri, njera prane Regjistrin Tregtar dhe nga nje per sejcilen pale, te cilet pasi e lexojne dhe e gjejne te formuluar drejte e nenshkruajne me vullnet te lire.

Une noterja pasi u binda per shprehjen e vullnetit te lire te paleve lejoj nenshkrimin dhe bej legalizimin sipas ligjit.

SHITESI

*Ardian Mullahi*  
(Ardian Mullahi)

*Melsi Toska*



Adresa: Rruga e Durrësit, P. 11, Sh. 1, Ap. 1  
TIRANE, ALBANIA, Tel./Fax: 00355 42 38839

BLERESI

MELSI TOSKA.

*Melsi Toska*  
(Melsi Toska)

NOTERE  
LINDITA KOKONA  
TIRANE ALBANIA

*[Handwritten signature]*

